

Komiteti për siguri i EMA-s vazhdon investigimin e vaksinave COVID-19 AstraZeneca dhe ngjarjeve tromboembolike - përditësimi i mëtejshëm

Lajme 15/03/2021

Disa autoritete përgjegjëse për fushatat kombëtare të vaksinave në vendet e UE-së kanë ndaluar përkohësisht vaksinimin me COVID-19 Vaksina AstraZeneca. Kjo është një masë paraprake e ndërmarrë për shkak të situatës së tyre kombëtare ndërkohë që EMA është duke investiguar një numër ngjarjesh të mpiksjes së gjakut tek njerëzit që kishin marrë vaksinën, siç është raportuar më parë.

Ngjarje që përfshijnë mpiksjen e gjakut, disa me karakteristika të pazakonta siç janë numri i ulët i trombociteve, kanë ndodhur në një numër shumë të vogël njerëzish që morën vaksinën.

Me mijëra njerëz pësojnë mpiksje gjaku çdo vit në UE për arsye të ndryshme. Numri i ngjarjeve tromboembolike në përgjithësi tek njerëzit e vaksinuar duket se nuk është më i lartë se ai që shihet në popullatën e përgjithshme.

EMA është duke punuar ngushtë me kompaninë, me ekspertët për çrregullimet e gjakut dhe me autoritete të tjera shëndetësore duke përfshirë MHRA të Mbretërisë së Bashkuar bazuar në përvojën e saj me rreth 11 milion doza të administruara të vaksinës.

Hetimi i EMA-s ka vazhduar gjatë fundjavës dhe analiza rigoroze e të gjitha të dhënave në lidhje me ngjarjet tromboembolike do të kryhet në ditët në vijim. Ekspertët janë duke analizuar me shumë hollësi të gjitha të dhënat në dispozicion dhe situatat klinike që rrethojnë raste specifike për të përcaktuar nëse vaksina mund të ketë kontribuar, ose nëse ngjarja ka mundësi të ketë qenë për shkaqe të tjera.

Komiteti për siguri i EMA-S (PRAC) do të shqyrtojë më tej informacionin nesër (e martë) dhe ka thirrur një takim të jashtëzakonshëm të enjten me 18 mars për të konkluduar lidhur me informacionet e mbledhura dhe çdo veprim tjetër që mund të duhet të ndërmerret.

Pandemia COVID-19 është një krizë globale, me ndikim shkatërrues shëndetësor, social dhe ekonomik dhe vazhdon të jetë një barrë e madhe për sistemet shëndetësore të UE-së. Vaksinat për COVID-19 ndihmojnë për të mbrojtur individët nga sëmundja, veçanërisht profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe popullatat e prekshme, siç janë personat e moshuar ose ata me sëmundje kronike.

Ndërkohë që investigimi është duke vazhduar, EMA aktualisht mbetet e mendimit se përfitimet e vaksinës AstraZeneca në parandalimin e COVID-19, me rrezikun e lidhur të hospitalizimit dhe vdekje, tejkalojnë rreziqet e efekteve anësore.

EMA do të vazhdojë të komunikojë më tej kur është e përshtatshme. Në ndërkohë, kushdo që ka marrë vaksinën dhe ka ndonjë shqetësim duhet të kontaktojë një profesionist të duhur të kujdesit shëndetësor. Është e rëndësishme që njerëzit që dyshojnë se mund të kenë një efekt anësor pas vaksinimit, ta raportojnë këtë tek autoriteti rregullator kombëtar i barnave ose tek një profesionist i kujdesit shëndetësor i cili mund t'i ndihmojë ata ta bëjnë këtë.

Më shumë informacione rreth barit

Vaksina COVID-19 AstraZeneca është një vaksinë për parandalimin e sëmundjes së koronavirusit 2019 (COVID-19) te njerëzit e moshës 18 vjeç e lart. COVID-19 shkaktohet nga virusi SARS-CoV-2. Vaksina COVID-19 AstraZeneca përbëhet nga një virus tjetër (i familjes adenovirus) që është modifikuar për të përmbajtur gjenin për prodhimin e një proteine nga SARS-CoV-2. Vaksina COVID-19 AstraZeneca nuk përmban vetë virusin dhe nuk mund të shkaktojë COVID-19.

Efektet anësore më të zakonshme me vaksinën COVID-19 AstraZeneca janë zakonisht të lehta ose të moderuara dhe përmirësohen brenda disa ditësh pas vaksinimit.

Informacione më të hollësishme mund të gjenden në webfaqen e Agjencisë Europiane të Barnave (EMA): <https://www.ema.europa.eu/en/news/emas-safety-committee-continues-investigation-covid-19-vaccine-astrazeneca-thromboembolic-events>